

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“Java One Development Albania” SH.P.K**

Sot me date 16.06.2020,

Z.Bruno Mërtiku, i ditelindjes 09/04/1987, banues ne Tirane, identifikuar me ID Nr. I70409093V shtetas shqiptar, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, do te ushtrojne aktivitet si person juridik me vullnet te lire te plote, bazuar ne dispozitat ligjore ne fuqi ne Republiken e Shqiperise si:

- Kushtetuta e RSH, miratuar me referendum me 22.11.1998
- Kodi Civil , miratura me Ligjin nr 7850, dt 29.07.1994 (I ndryshuar)
- Ligji nr 9723, date 03.05.2007 “Per QKR”,
- Ligji nr. 131/2015”Per Qendren Kombetare te Biznesit”,
- Ligji nr 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”
- si dhe te gjithe legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Deklaroj vullnetin per te themeluar Shoqerine Tregtare“**Java One Development Albania**” shpk, shoqeri e se drejtes tregtare shqiptare te cilen vendosi ta themeloje sot me date 16.06.2020.

Une si Ortake i Vetem dhe Themeluese, vendosa ta miratoj Statutin si me poshte vijon:



## STATUT

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### “Java One Development Albania ” SH.P.K

Sot me date 16 .06.2020, Une Z.Bruno Mërtiku, i ditelindjes 09/04/1987, banues ne Tirane, identifikuar me ID Nr. I70409093V, shtetas shqiptar, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, do te ushtrojne aktivitet si person juridik me vullnet te lire te plote, bazuar ne dispozitat ligjore ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, kam vendosur te themelojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar “**Java One Development Albania**”shpk, me vullnetin tim te lire hartoj Statutin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “Java One Development Albania”shpk ne perputhje me Ligjin nr. Nr.9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, ne perputhje me Ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, Ligjin nr.131/2015 “Per Qendren Kombetare te Biznesit”.

#### KREU I

#### Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

##### Neni 1

##### Emertimi

1. Emertimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte “**Java One Development Albania**” shpk.

##### Neni 2

##### Forma Juridike

Shoqeria “Java One Development Albania”shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Shoqeria “Java One Development Albania” shpk, kapitali i se ciles ndahet ne kuota dhe ortaku i vetem perballon humbje vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te saj ne kapitalin themeltar.

##### Neni 3

##### Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen: Rruga “ Ibrahim Kodra, Pallati “ Hawai”, shkalla 1, Kati 10, Ap 81/1, Komuna e Parisit Tirane.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

##### Neni 4



### **Objekti**

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte: Projektim dhe zhvillim i sistemeve software. Analize dhe projektim i arkitektures per sisteme software. Projektim dhe zhvillim i aplikacioneve te bazuara ne teknologjite Web dhe mobile. Mirembajtje dhe permiresim i sistemeve software. Projektim, zhvillim dhe mirembajtje e bazave te te dhenave. Ndertimi dhe instalimi i platformave per monitorimin e sistemeve kompjuterike. Konsulence ne automatizimin e proçeseve te biznesit ndermjet zgjidhjeve softwarike. Programi i sistemeve software, integrimi i sistemeve me pale te treta dhe hostimi i sistemeve ne infrastrukturen lokale ose ne cloud. Zhvillimi i zgjidhjeve per integrimin e sistemeve softwarike te ndryshme me njeri-tjetrin.

### **Neni 5**

#### **Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tyre per nje periudhe kohore te pakufizuar.

## **KREU II**

### **KAPITALI**

### **Neni 6**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.

Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar nga ortaku i vetem Z.Bruno Mërtiku, zoterues i 1 kuote me vlere nominale, kuota 100.000 leke, qe perben 100 % te kapitalit themeltar.

Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta)

### **Neni 7**

#### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga ortaku, i cili marrin vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

### **Neni 8**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejttat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;



d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Ky statut kushtezon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqerise, me miratimin e shoqerise dhe te drejten e parablerjes ne favor te shoqerise apo te ortakeve te tjere, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te tyre ne Qendren Kombetare te Biznesit, sipas nenit 43 te Ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

### **KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 9**

##### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Pergjithshme eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Te drejtat dhe detyrimet e Asamblese se Pergjithshme ushtrohen nga ortaku i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Te gjitha vendimet e marra nga ortaket e shoqerise regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u



kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

#### **Neni 10**

##### **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e te dergohet jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

#### **Neni 11**

##### **Kuorumi**

- a) Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.
  - b) Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.
- Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

#### **Neni 12**

##### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per çeshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori/et , perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;



Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### **Neni 13** **Administrimi**

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator .

Administrator i shoqerise eshte Z. Bruno Mertiku.

Administratori do te ushtroje detyrat e tyre sipas statutit dhe ligjit per nje periudhe 5 vjecare me te drejte riperteritje.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje Administratorin/et ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Statuti, apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte. Pervec ketyre, Administratori/et shkarkohen nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkese te çdonjerit prej ortakeve.

Tagrat e perfaqesimit te administratorit/eve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Emerimi i administratorit/eve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person jashte ortakerise.

### **Neni 14** **Kompetencat**

Administratori ka te drejte e detyrohen te:

a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;

b) perfaqesojne shoqerine tregtare;

c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;

ç) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shpermdarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;

d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;

dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;

e) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

Administratori/et jane te detyruar te therrasin asamblene e pergjithshme edhe ne rastet kur :

- asambleja e pergjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe

- kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te tyre, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.



Administratori/et kane te drejte te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori/et perfaqesojne Shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratori/et kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori/et angazhojne shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e tyre.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i Administratorit/eve e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin/et ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## **Neni 15**

### **Pergjegjesite**

Administratori/et jane pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit/eve dhe ortakut/ve qe kane bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

c) te vleresoje me pergjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim;

ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administratori/et, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.



3. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

4. Ne menyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:

a) u kthen ortakeve kontributet;

b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;

c) u shperndan aktivet shoqerise;

ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Perveç padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme.

Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

### **Neni 16**

#### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

### **Neni 17**

#### **Bilanci i shoqerise dhe dividendet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori/et.

Mbledhja e Asamblese vendos rreth shperndarjes se dividetit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

### **Neni 18**

#### **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te





ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

#### **Neni 19**

Te ardhurat neto ( Dividenti ) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi te ortakeve.

#### **Neni 20**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e tyre;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Asambleja e Ortakeve.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

#### **Neni 21**

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

Nese shoqeria emerom me shume se nje likuidues, perveçse kur akti i emerimit parashikon se ata veprojne veçmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojne bashkerisht te drejtat e detyrimet sipas ketij ligji. Likuiduesit mund te autorizojne njerin prej tyre te kryeje veprime te nje kategorie te posaçme. Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te treteve, ne perputhje me percaktimet e ligjit. Likuiduesi u nenshtrohet mbikeqyrjes se ortakut dhe administratorit/eve.

#### **Neni 22**

#### **Te drejtat e detyrimet e likuiduesit**



1. Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund te kryeje edhe veprime te reja tregtare, per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar.
3. Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 te ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, likuiduesit verejne se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojne proceduren e likuidimit e t’i kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.

Likuiduesi pergatit nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne çastin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne çastin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedura e likuidimit zgjat me shume se nje vit, likuiduesi pergatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore te shoqerise.

### **Neni 23**

#### **Perfundimi i likuidimit**

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon çregjistrimin e shoqerise, ne perputhje me seksionin V te Ligjit nr.9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”.

### **Neni 24**

#### **Ndarja**

1. Nje shoqeri mund te ndahet me vendim te Asamblese se Ortakeve, duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume shoqerive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shoqeria qe ndahet, vleresohet e prishur.
2. Per ndarjen e shoqerise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve 216 deri ne 225 te ligjit 9901 date 14.04.2008.
3. Regjistrimi i ndarjes se shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ka si pasoje:
  - a) kalimin te shoqerite pritese te te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise qe ndahet, ne perputhje me raportin e ndarjes, te percaktuar ne marreveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja per marredheniet ndermjet shoqerive, si dhe per palet e treta;
  - b) berjen e aksionareve/ortakeve te shoqerise qe ndahet aksionare apo ortake te nje ose me shume shoqerive pritese, ne perputhje me raportin e ndarjes, percaktuar ne marreveshjen e ndarjes;
  - c) vleresimin e shoqerise qe ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e tyre nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, sipas seksionit V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” pa kryerjen e likuidimit.

### **Neni 25**

#### **Shnderrimi**



Shoqeria mund ta ndryshoje formen e vet ligjore, nepermjet shnderrimit te tyre ne shoqeri aksionare.

Shnderrimi nuk sjell pasoja mbi te drejtat e detyrimet, qe shoqeria ka marre persiper ndaj te treteve.

#### **Neni 26**

##### **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### **Neni 27**

##### **Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

#### **Neni 28**

##### **Dispozita perfundimtare**


Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i shoqerise tregtare "**Java One Development Albania**" shpk dhe nenshkruhet ne te gjitha kopjet.

Autorizohet administratori Z.Bruno MËRTIKU per te depozituar statutin e shoqerise prane QKB-se dhe te ndjekin te gjitha procedurat ligjore per regjistrimin e saj si person juridik.

#### **ORTAKU I SHOQERISE**

**"Java One Development Albania" shpk**

**Bruno MËRTIKU**

Handwritten signature of Bruno Mërtiku in black ink, consisting of a cursive script that reads 'Bruno Mërtiku' followed by a long horizontal flourish.